



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 28.2.2024

Nr: 27

Ora: 12:00

VENDIM
PËR

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË KAVAJË, ME
KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E KOALICIONIT “BASHKË
FITOJMË”, ZJ. KLEDJA SHKËLQIM VISHKULLI**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 780 prot., datë 07.02.2024, Këshilli i Bashkisë Kavajë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zj. Fatmire Hysen Kuli, propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë.”

Referuar nenit 164, pika 2 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, për Këshillin e Bashkisë Kavajë, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 10, zj. Kledja Shkëlqim Vishkulli.

Me shkresën nr. 465, prot., datë 19.2.2024, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Kavajë, zj. Kledja Shkëlqim Vishkulli, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Këshillin Bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore, të subjektit Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër TR-BF-21946-1 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Data: 28.2.2024 Nr: 27
Ora: 12:00



“Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Kavajë, me kandidatin nga lista shumemërore e Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, zj. Kledja Shkëlqim Vishkulli”

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të zj. Kledja Shkëlqim Vishkulli, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 me shkresën nr. 497 prot., datë 21.02.2024, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe me shkresën nr. 498 prot., datë 21.02.2024, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore për zj. Kledja Shkëlqim Vishkulli.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë, për verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar zj. Kledja Shkëlqim Vishkulli, në Këshillin e Bashkisë Kavajë.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për zj. Kledja Shkëlqim Vishkulli, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar zj. Kledja Shkëlqim Vishkulli, në Këshillin e Bashkisë Kavajë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreun V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

V E N D O S:

1. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Kavajë, me kandidatin nga lista shumemërore e Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, zj. Kledja Shkëlqim Vishkulli.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Iirjan CELIBASHI